



**KRYEMINISTRIA**  
**MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN**

**URDHËR**

**Nr. 13, datë 31. 12. 2020**

**“PËR**  
**NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.5 DATË 26.2.2020 TË MINISTRIT**  
**TË SHTETIT PËR DIASPORËN. PËR “MIRATIMIN E ANËTARËVE TË**  
**KËSHILLIT KOORDINUES TË QENDRËS SË STUDIMEVE DHE**  
**PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT”**

Në mbështetje pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës ë), të nenit 5, ligjit nr. 16/2018, datë 05.04.2018, “Për diasporën”, të pikave 8, 9, 10 dhe 11 të Vendimit Nr. 601, 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”, me propozim të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, nëpërmjet shkresës Nr. 856/1 Prot., datë 29.12.2020,

**URDHËROJ:**

Në pikën 1 të Urdhrit Nr. 5, datë 26.02.2020, të Ministrit të Shtetit për Diasporën, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Prof. Dr. Flora Koleci, anëtare, zëvendësohet për pjesën e mbetur të mandatit nga Prof. Dr. Sezai Rokaj, si përfaqësues Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë.
2. Ngarkohet Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PANDELI MAJKO**  
**MINISTËR**